



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI JURIDIK
INSTITUTI PËR HULUMTIME DHE STUDIME JURIDIKE (IHSJ)

Instituti për Hulumtime dhe Studime Juridike (IHSJ) i Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, duke u bazuar në nenin 16 të Ligjit Nr. 03/L 212 të Punës dhe me mbështetje të UNDP-se, shpall:

K O N K U R S

Për gjashtë (6) praktikantë me pagesë që do të kontribuojnë në punën hulumtuese-shkencore të IHSJ dhe avancimin e tyre në aspektin praktik.

Kohëzgjatja 6 muaj: 01 tetor 2020 – 30 mars 2021

Qëllimi i angazhimit të praktikantëve:

Praktikantët, sipas udhëzimeve dhe mentorimit të profesorëve të fushave të ndryshme të Fakultetit Juridik/UP-se, do të angazhohen për të bërë hulumtime të caktuara juridike në gjykata duke ndërlidhur aspektet teorike dhe praktike në fushën e sundimit të ligjit. Përmes kësaj metodologjie, synohet të bëhen publikime dhe studime juridike me interes të sistemit të drejtësisë në Kosovë.

Nëpunësi mbikëqyrës:

Praktikanti/Praktikantja vepron nën koordinimin e Institutit për Hulumtime dhe Studime Juridike (IHSJ) , dhe mbikëqyrjen e Administratorit/Admintratores të gjykatës përkatëse.

Kualifikimet e kërkuara:

- Kandidati/ja duhet të ketë të përfunduar studimet e nivelit bachelor/apo të jetë student i nivelit master në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës;
- Të ketë notën mesatare mbi tetë (8);
- Aftësi të shkëlqyeshme në hulumtime në fushën juridike, përpilimin me shkrim të akteve të ndryshme juridike, duke përfshirë aftësinë në përpilimin e dokumenteve ligjore, si dhe shkathtësi komunikimi në të folur;

- Të ketë aftësi të mira në shkrim dhe hulumtim ligjor;
- Të ketë aftësi të komunikimit verbal dhe me shkrim, kurse njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi;
- Të ketë shkathtësi organizative dhe vullnet për punë;
- Të ketë përkushtim dhe interesim për tu avancuar.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bënë hulumtime në fusha të ndryshme juridike-shkencore të caktuara nga IHSJ;
- Monitoron raste të caktuara në kuadër të fushës së hulumtimeve dhe studimeve të Institutit;
- Ndhmon gjyqtarin /en për përgatitjen e lëndëve për seanca dëgjimore dhe veprime tjera;
- -Ndhmon në hartimin dhe përgatitjen e draft vendimeve, opinioneve dhe punë të tjera brenda zyrës;
- Kontribuon në planifikimin e aktiviteteve të Institutit në koordinim me menaxhmentin e Institutit;
- Kryen detyrat tjera profesionale të caktuara nga gjykata dhe menaxhmenti i Institutit;

Vendi punës:

Praktikanti/Praktikantja do të jetë i vendosur ne departament te caktuar në gjykata të niveleve te ndryshme.

Orari i punës:

Orari i punës zgjat njëzet (20) orë në javë.

Dokumentacioni për aplikim:

- Biografia (CV)
- Letra motivuese;
- Certifikata e notave

Procedura e përzgjedhjes:

Kandidatët te cilët i plotësojne kriteret e lartpërmenduar, do t'i nënshtrohen intervistës verbale të organizuar nga Komisioni vlerësues në përbërje të Fakultetit Juridik/IHSJ dhe UNDP-së.

Procedura e aplikimit:

Studentët e interesuar mund të aplikojnë nga data **05 shtator deri më 12 shtator 2020**, në adresën elektronike: **ihshj@uni-pr.edu** dhe duke bashkangjitur CV-në, letrën motivuese dhe certifikatën e notave.

Procesi i rekrutimit do të jete i hapur, transparent, konkurrues dhe i bazuar në konkurs.

Instituti për Hulumtime dhe Studime Juridike ofron mundësi të barabarta të angazhimit për të gjithë studentët e interesuar në këte përvoje unike të punës.